

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kunder te pandehurit S.B.nga fshati D. Komuna e K., për shkak të veprës penale Ngacmim nga neni 186 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2631/16, të datës 12.02.2018, jashtë seancës, me datë 19.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr.2631/16, të dates 12.02.2018, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

S.B., nga i ati Xh. dhe e ëma Sh. e gjinisë B., i lindur me .., në fshatin D. Komuna e K., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me date 02.05.2016, rreth orës 17:00, në K. Komuna e G., i pandehuri kishte ngacmuar të dëmtuarën M.M., duke bërë sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të pa dëshirueshme dhe duke vënë në vëzhgim të dëmtuarën me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit, në atë mënyrë që, i pandehuri kishte shkuar me veturën dhe duke u sjellur afër shtëpisë, pastaj kishte hyrë në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarës dhe i kishte kthyer veturën, krejt kjo kishte ardhur pasi që e dëmtuara nuk kishte pranuar që të vazhdon lidhjen me të pandehurin, sjelljet dhe veprimet e të pandehurit kanë sjell shqetësim dhe frikë te e dëmtuara dhe familja e saj,-

- **me këtë ka kryer veprën penale Ngacmim nga neni 186 par.1 të KPK-së.**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) vite nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

E dëmtuara: M.M., nga fshati K. Komuna e G., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 2631/16, të datës 12.02.2018, kundër të akuzuarit S.B.nga fshati D. Komuna e K., për shkak të veprës penale Ngacmim nga neni 186 par.1 të KPK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi penal, Deklarata e te demtuarës, Deklarata e të pandehurit, deshmitarëve, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftushme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Ngacmim nga neni 186 par.1 të KPK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr. 671/18, të dt. 19.04.2018

Zyrtare Ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.